REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më Data 28-04-2025 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. Lomgorit | | Shtojca | Vlera Vrednost |
| 02- | 035/ | 02- | 338 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale NR.03/L-040(Gazeta Zyrtare NR 28/2008), dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, dhe sipas kërkesës me numër protokolli 02-320/04-10608 e datës 23.04.2025 nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dega në Viti, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datës 28.04.2025, merr këtë:

# VENDIM

## PËR CAKTIMIN E ZYRËS SË SHOQATËS SË INVALIDËVE TË LUFTËS SË UÇK-SË –DEGA NË VITI

I. Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë, aporovon kërkesën e lartëcekur dhe cakton zyrën për Shoqatën e Invalidëve të luftës së UÇK-së, dega në Viti.

II. Zyra e Shoqatës së Invalidëve të luftës së UÇK-së, dega në Viti, caktohet tek ish objekti i Kadastrit, përballë Bankës Ekonomike.

III. Zyra në kati dytë (2), përballë zyrës së AAK-së.

IV. Ky vendim hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të tij nga Kryetari i Komunës së Vitisë, dhe vlen deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër.

V. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Shoqata e Invalidëve të Luftës së UCK-së, dega në Viti.

## Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozita e lartcekura ligjore, dhe duke pasura parasysh kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, dega ne Viti, të cilëve ju duhet një zyre pune në organizimin e aktiviteteve, që të ofrojnë shërbime për anëtarët dhe të zhvillojn takime dhe projekte në shërbim të komunitetit dhe kategorive të dala nga lufta, Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimev ligjore, merr vendim për caktimin e zyres së Shoqatës së Invalidëve të luftës së UÇK-së, dega në Viti.
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e paknaqur mund të paraqesë ankesë Komisonit për Ankesa dhe Parashtresa të komunës së Vitisë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:
1. SHIL-UÇK-së –dega në Viti.
2. Zyrës së Kryetarit
3.Zyres Ligjore,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti